
Kursi i kembimit	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
EUR/LEK	123.70	121.77

3.2 Instrumenta financiare

Instrumentat financiare perbehen nga mjetet monetare, nje instrument borxhi (si llogari, deftese ose hua e arketueshme ose e pagueshme) qe plotesojne kushtet, hua te marra ose te dhena dhe detyrime financiare. Instrumentat financiare njihen fillimisht me kosto plus cdo kosto transaksioni qe lidhet me to. Kostoja eshte (a) vlere e drejte e parase ose e ekuivalenteve te saj te paguara ose vlere e drejte e shperblimeve te dhena per te blere nje aktiv ne kohen e blerjes ose te ndertimit te tij (b) shuma e parase ose e ekuivalenteve te saj te arketuara ose vlere e drejte e shperblimeve te marra per te shitur nje detyrim ne kohen e shitjes ose likuidimit te tij.

Nje instrument financiar njihet nese Shoqeria behet pjese e kushteve kontraktuale te instrumentit. Aktivitetet financiare cregjistrohen kur skadojne te drejtat kontraktuale te Shoqerise mbi flukset e parase se aktivitetit financiar ose kur Shoqeria transferon aktivin financiar tek nje pale e trete pa mbajtur kontrollin ose gjithe risqet dhe perfitimet thelbeshore te aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale te aktiveve financiare kontabilizohen ne daten e transaksionit, qe eshte data ne te cilen njesia ekonomike angazhohet te bleje apo te shese aktivin. Detyrimet financiare cregjistrohen nese detyrimet kontraktuale te Shoqerise skadojne, shfuqizohen ose anulohen.

Aktivitetet monetare

Aktivitetet monetare perfshijne arken, llogarite rrjedhese dhe depozitat ne banke. Per qellimin e pasqyres se fluksit te parase, aktivitetet monetare perfshijne depozita me afat me nje maturim prej tre muajsh ose me pak qe nga data e fillimit.

FINSEC PORT SHA

Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(te gjitha shummat jane te shprehura ne lek)

3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.2 Instrumenta financiare (vazhdim)

Te drejtat e arketueshme

Te drejtat e arketueshme njihen fillimisht me vleren e drejte dhe me pas me kosto te amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvleresimi. Provizioni per zhvleresimin e aktiveve te arketueshme llogaritet kur ka te dhena se Shoqeria nuk do te jete ne gjendje te mbledhe te gjitha detyrimet. Veshiresite financiare te debitorit, mundesia qe debitori te falimentoje ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues qe te drejtat e arketueshme te zhvleresohen. Shuma e provizionit llogaritet si diference midis vleres se mbetur dhe vleres aktuale te flukseve te ardhshme te parashikuara te parase te skontuara me normen e interesit efektiv.

Llogari te pagueshme

Llogarite e pagueshme paraqiten me kosto dhe me pas me kosto te amortizuar, duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Tituj te huadhenies dhe huamarrjes

Tituj te huadhenies dhe huamarrjes njihen me kosto minus zhvleresim, pa perfshire koston e transaksioneve. Humbja nga zhvleresimi eshte diferenca mes vleres kontabel te aktivitetit dhe vleresimit me te mire qe njesia mund te marre per aktivitetin nese ai do te shitej ne daten e raportimit. Interesat e njohura ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve jane perlllogaritur mbi bazen e interesit nominal.

3.3 Inventaret

Inventaret njihet fillimisht me kosto historike dhe ne vijim vleresohet me vleren me te vogel mes koston dhe cmimit te realizuar te shitjes i zvogeluar me shpenzimet e ndryshueshme te shitjes. Kostoja e inventarit perfshin koston e te gjitha materialeve te lidhura drejtperdrejt me prodhimin dhe koston e shnderrimit te ketyre materialeve ne produkte perfundimtare. Kur inventaret konsumohen, vlera e tyre e mbetur njihet si shpenzim ne periudhen ne te cilen e ardhura perkatese njihet. Shuma e renes ne vlere te inventareve deri ne cmimin e realizuar te shitjes si dhe te gjitha humbjet nga inventaret njihen si shpenzime ne periudhen ne te cilen renia ne vlere apo humbja ndodh.

3.4 Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Te gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvleresimin dhe amortizimin e akumuluar. Kostoja perfshin shpenzime te cilat lidhen drejtperdrejt me blerjen e aktivitetit. Kostoja e aktiveve te vete-ndertuara perfshin koston e materialeve dhe punes direkte, cdo kosto tjeter te lidhur drejtperdrejt me sjelljen e aktivitetit ne gjendje pune per qellimin e synuar te perdorimit, si dhe kosto cmontimit, heqjes se pjeseve dhe sjelljes ne gjendjen e meparshme te vendodhjes se aktivitetit. Shpenzimet kapitale te aktiveve te bera gjate ndertimit kapitalizohen ne "Ndertim ne proces" dhe transferohen ne kategorine perkatese te aktivitetit kur perfundon ndertimi i tij, nga kur aplikohet amortizimi perkates sipas kategorise. Ne rastet kur pjese te nje aktiviteti afatgjate material kane jetegjatesi te ndryshme, ato kontabilizohen si zera te ndryshem (komponentet me te medhenj) te aktiveve afatgjata materiale. Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashte perdorimit percaktohen duke krahasuar vleren e shitjes me vleren e mbetur dhe keto perfshihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mepasshme

Kostoja e zevendesimit te nje pjese te nje zeri te aktiveve afatgjata materiale njihet ne vleren kontabel te atij zeri nese eshte e mundshme qe shoqeria do te realizoje perfitime te ardhshme ekonomike nga perdorimi i pjeses zevendesuese dhe kostoja e pjeses mund te matet ne menyre te besueshme. Kostot e sherbimeve te zakonshme te aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

FINSEC PORT SHA

Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(te gjitha shummat jane te shprehura ne lek)

3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.4 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke perdorur metoden e vleres se mbetur te amortizimit mbi jeten e vleresuar te cdo pjese te aktivitet afatgjate material duke filluar nga dita e pare e muajit qe pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marre per baze periudhen me te shkurter midis periudhes se qirase dhe jetes se dobishme te aktivitet. Toka nuk amortizohet.

Metoda e amortizimit, jeta e dobishme dhe vlera e mbetur rishikohen ne cdo date raportimi.

3.5 Aktivet afatgjata jo-materiale

Marreveshje per sherbime koncesionare

Shoqeria njej nje aktiv afatgjate jo-material nga nje marreveshje sherbimi koncesionare ne momentin kur i lind e drejta per perdorimin e infrastruktures se koncesionit. Aktivet afatgjata jo-materiale maten fillimisht me kosto, e cila eshte vlera e drejte e paguar per te ofruar sherbimet koncesionare te marreveshjes koncesionare. Pas njohjes fillestare aktivet afatgjata jo-materiale maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjen e akumuluar nga zhvleresimi.

Shoqeria ka aplikuar SKK 13 "Aktivet Biologjike dhe Marreveshjet Koncesionare". Ne perputhje me kete Standart dhe ne baze te kushteve te Kontrates se Koncesionit, Shoqeria ka paraqitur ne Pasqyrat Financiare modelin e Aktivitet Afatgjat Jomaterial per investimin qe po kryen.

Ne perputhje me marreveshjen ndermjet Shoqerise dhe entitetit publik kontraktues, aktivet afatgjata jo-materiale perfshijne elemente te shperblimeve jo-monetare ne kembim te sherbimeve koncesionare te ofruara.

E drejta per te ofruar sherbime koncesionare ne kembim te perdorimit te infrastruktures te Portit te Jahteve, njihet ne koston e investimit per projektim, financim, rehabilitim, testim, mirembajtje dhe perdorim te Portit te Jahteve per te cilin konsiderohet si vlera e drejte e tij.

Gjithashtu ne baze te Kontrates se Koncesionit, Shoqeria do te riinvestoje ne pasuri te paluajtshme dhe te luajtshme 13% e vleres efektive te investimit sipas nevojave per ruajtjen e standarteve te portit. Kjo vlere do te investohet duke filluar nga viti 31.

Ne perputhje me Standartin Kombetar te Kontabilitetit (SKK 3) Instrumentat Financiar, shuma e riinvestimit eshte klasifikuar dhe paraqitur ne pasqyrat financiare si nje detyrim kontraktual (detyrim financiar) matur me koston e amortizuar. Detyrimi financiar eshte nje detyrim kontraktual per te dhene para ose nje aktiv tjetere financiar tek nje njesi ekonomike tjetere ose te shkembeje aktivin/detyrimin financiar ne kushtet te cilat jane potencialisht te pafavorshme per njesine ekonomike.

Detyrimi per te riinvestuar 13% te vleres totale te investimit eshte njohur si nje detyrim financiar meqenese daljet e burimeve qe perfaqesojne perfitime ekonomike, do te nevojiten per te mbyllur detyrimin ne 5 vitet e fundit te periudhes se marreveshjes. Ne vitin 2013, Shoqeria ka llogaritur vleren aktuale ne shumen LEK 62,319,620 te detyrimin per shumen e riinvestimit ne vleren ($13\% * 4,450,000,000 = 578,500,000$) duke perdorur nje norme borxhi te brendshme te shoqerise miratuar paraprakisht nga ortaket e shoqerise.

FINSEC PORT SHA

Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(te gjitha shumat jane te shprehura ne lek)

3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.5 Aktivet afatgjata jo-materiale (vazhdim)

Shpenzimet vijuese

Shpenzimet vijuese kapitalizohen vetem kur ato rrisin perfitimet e ardhshme ekonomike te perfsjire specifiku ne aktivin te cilit i perkasin. Te gjitha shpenzimet e tjera njihen ne pasqyrat e te ardhurave permbledhese (ne fitim ose humbje) kur ndodhin.

Amortizimi

Jeta e dobishme e vleres se mbetur te aktivitet afatgjate jo-material qe i perket marreveshjes se sherbimit koncesionar eshte periudha qe kur eshte ne dispozicion per perdorim deri ne fund te periudhes se koncesionit

3.6 Te ardhurat

Te ardhurat njihen atehere kur eshte e mundshme qe njesia ekonomike te kete perfitime ekonomike ne te ardhmen dhe keto perfitime mund te maten me besueshmeri. Te ardhurat maten me vleren e drejte te shumes se arketuar ose te arketueshme dhe ne vleresimin e vleres se drejte merren ne konsiderate edhe zbritjet e mundshme qe i behen cmimit te transakcionit.

3.7 Te ardhurat dhe shpenzimet financiare

Te ardhurat financiare perfshijne te ardhura interesi nga llogarite bankare dhe fitime nga kursi i kembimit qe njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Te ardhurat nga interesi njihen mbi bazen e te drejtave te konstatuara duke perdorur metoden e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare perfshijne shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i kembimit, ndryshimet ne vleren e drejte te aktiveve financiare te mbajtura me vlere te drejte nepermjet llogarise fitim/humbje dhe humbjet nga zhvleresimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve me metoden e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet nga kurset e kembimit raportohen ne baze neto.

3.8 Shpenzime te personelit

Kontributet e detyrueshme per sigurimet shoqerore

Gjate ecurise normale te biznesit, Shoqeria ben pagesa ne emer te saj dhe te punonjesve per kontributet e detyrueshme te pensioneve sipas legjislacionit vendor. Keto kosto te kryera ne emer te Shoqerise, jane te paraqitura ne pasqyren permbledhese te te ardhurave ne momentin qe ndodhin.

3.9 Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtperdrejte ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve. Tatimi i vitit eshte tatimi i pritshem per t'u paguar mbi te ardhurat e tatueshme te vitit, duke perdorur normat tatimore te miratuara gjate vitit.

Tatimi mbi fitimin llogaritet duke u bazuar ne ligjin nr. 8438 date 28.12.1998 ne fuqi per "Tatimin mbi te ardhurat". Shpenzimi i tatimit mbi fitimin perfshin te gjitha barren per vitin korrent. Norma e tatimit mbi fitimin per vitin financiar 2020 eshte 15 % (2019: 15%).

3.10 Provizionet

Provizionet njihen kur si rezultat i ngjarjeve ne te kaluaren, Shoqerise i linden detyrime (ligjore ose konstruktive) te cilat mund te parashikohen me besueshmeri dhe eshte e mundur qe te ndodhe nje dalje e perfitimeve ekonomike per shlyerjen e detyrimit. Nese efekti eshte material, provigjionet jane percaktuar duke ju zbritur vleren e pritshme te flukseve te parase te aktualizuara me nje norme para tatimit qe reflekton vleresimet aktuale te tregut per vleren ne kohe te parase dhe rreziqet specifike te detyrimeve. Provigjionet rishikohen ne çdo date raportimi dhe nese nuk eshte me e nevojshme qe nje dalje e mundshme burimesh qe perfshin perfitime ekonomike per shlyerjen e detyrimit, provigjionet rimerren.

FINSEC PORT SHA

Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(te gjitha shumat jane te shprehura ne lek)

3. POLITIKAT KONTABEL (VAZHDIM)

3.11 Transaksionet me palet e lidhura

Palet e lidhura perbehen nga aksionaret dhe drejtoret e Shoqerise, se bashku me entitetet qe kontrollojne, qe kane nje ndikim te rendesishem mbi veprimtarite dhe drejtimin e Shoqerise. Ne marrjen ne konsiderate te çdo maredhenie te mundshme me palet e lidhura, vemendja i drejtohet thelbit te maredhenies, jo vetem formes ligjore.

3.12 Angazhime dhe detyrime te ardhshme

Detyrimet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare. Per nje detyrim te kushtezuar jepet informacion shpjegues vetem kur mundesia e nje daljeje burimesh qe perfshin perfitime ekonomike nuk ekziston me. Aktivitet e kushtezuara nuk njihen ne pasqyrat financiare por jepet informacion shpjegues kur realizimi i te ardhurave eshte i mundur. Shuma e humbjes se kushtezuar njihet si provigjion nese eshte e mundur qe nje ngjarje e ardhshme do ta konfirmojne ate, nje detyrim lind ne daten e pozicionit financiar dhe mund te behet nje vleresim i arsyeshem i humbjes.

3.13 Krahasueshmeria

Shifrat krahasuese jane riklasifikuar aty ku eshte e pershtatshme qe te jene ne perputhje me ndryshimet ne prezantim e periudhes aktuale. Sidoqofte, keto riklasifikime nuk kane rezultuar ne ndryshime te rendesishme ne permbajtjen dhe formatin e informacionit financiar, siç paraqiten ne pasqyrat financiare.

FINSEC PORT SHA**Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020***(te gjitha shumat jane te shprehura ne lek)***4. Aktivet monetare**

Aktivet monetare me 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Mjete monetare ne banke (ALL)	111,149	167,634
Mjete monetare ne banke (EUR)	3,185,332	1,934,854
Mjete monetare ne arke	199,955	199,954
Total	<u>3,496,436</u>	<u>2,302,442</u>

5. Te tjera te arketueshme

Te tjera te arketueshme me 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Shteti - TVSH e zbritshme	179,536,810	155,173,905
Parapagime te dhena ndaj furnitoreve	47,081,342	78,850,114
Total	<u>226,618,152</u>	<u>234,024,019</u>

6. Shpenzime te shtyra

Shpenzime te shtyra me 31 dhjetor 2020 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Shpenzime te periudhave te ardhme	6,390,671	162,167
Total	<u>6,390,671</u>	<u>162,167</u>

FINSEC PORT SHA**Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020***(te gjitha shumat jane te shprehura ne lek)***7. Aktivet afatgjate jo-materiale**

Aktivi afatgjate jo-material me 31 dhjetor 2020 perbehen si me poshte:

	<u>Aktive ne Proçes</u>	<u>Total</u>
<u>Kosto historike me 1 janar 2020</u>		
Kosto historike me 1 janar 2020	1,240,509,266	1,240,509,266
Shtesa	392,072,927	392,072,927
Pakesime	-	-
Rivlersime	-	-
Me 31 dhjetor 2020	<u>1,632,582,193</u>	<u>1,632,582,193</u>
<u>Amortizimi Akumuluar</u>		
Amortizimi i akumuluar 1 janar 2020	-	-
Amortizimi per vitin	-	-
Amortizim per pakesimet	-	-
Amortizimi per rivleresimet	-	-
Me 31 dhjetor 2020	<u>-</u>	<u>-</u>
<u>Vlera kontabel neto</u>		
Vlera kontabel neto me 1 janar 2020	1,240,509,266	1,240,509,266
Vlera kontabel neto me 31 dhjetor 2020	<u>1,632,582,193</u>	<u>1,632,582,193</u>

Aktivitet afatgjate ne proces perfsihjne te gjitha blerjet e bera gjate vitit 2020 dhe vitet me pare te cilat lidhen drejtperdrejte me projektin e Finsec Port sha. Keto blerje konsistojne kryesisht ne sherbime qeraje me fadrome, sonde dhe mjetesh te tjera, sherbime supervizimi projekti, sherbime koordinimi projekti, shpenzim sigurim garancie kontrate, sherbime menaxhimi projekti si dhe kostot e financimit te projektit nga ortaket.

FINSEC PORT SHA**Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020***(te gjitha shumat jane te shprehura ne lek)***8. Llogari te pagueshme tregtare**

Llogari te pagueshme per aktivitetin e shfrytezimit me 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Llogari te pagueshme tregtare	37,231,728	114,850,955
Furnitore per fatura te pamberritura	834,759	435,328
Total	<u>38,066,487</u>	<u>115,286,283</u>

9. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019 detajohen si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Tatim fitimi	909,545	835,191
Detyrime per Sigurime Shoqerore & Shendetsore	30,690	87,115
Detyrime per tatimin mbi te ardhurat personale	6,501	24,700
Total	<u>946,736</u>	<u>947,006</u>

10. Te tjera detyrime

Te tjera detyrime per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 detajohen si me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Paga te pagueshme	547,080	296,500
Total	<u>547,080</u>	<u>296,500</u>

11. Titujt e huamarrjes

Titujt e huamarrjes me 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 perbehen nga sa me poshte:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Kontribut i ortakut Finsec AG	1,635,148,374	1,156,892,018
Kontribut i ortakut Victoria Invest	179,020,241	166,535,062
Detyrime financiare	100,071,690	93,524,945
Te tjera detyrime Finsec AG	-	1,359,925
Total	<u>1,914,240,307</u>	<u>1,418,311,934</u>

Ne zerin titujt e huamarrjes perfshihen kontributet e ortakeve ne llogarite bankare te shoqerise Finsec Port sha apo dhe pagesa per palet e treta ne emer te Finsec Port Sha. Per keto financime ortakët kane rene dakort paraprakisht se norma e interesit prej 7% do te aplikohet per titujt e huamarrjes.

FINSEC PORT SHA

Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(te gjitha shumat jane te shprehura ne lek)

Nga ana e Finsec AG, financimi i dakordesuar eshte materializuar nepermjet nenshkrimet me Finsec Port sha te nje kontrate te pergjithshme financimi.

Ne baze te Kontrates se Konkensionit shoqeria do te riinvestoje ne pasuri te paluajtshme dhe te luajtshme 13% e vleres efektive te investimit sipas nevojave per ruajtjen e standarteve te portit. Kjo vlere do te investohet duke filluar nga viti 31. Ne perputhje me Standartin Kombetar te Kontabilitetit (SKK 3) Instrumentat Financiar, shuma e riinvestimit eshte klasifikuar dhe paraqitur ne pasqyrat financiare si nje detyrim kontraktual (detyrim financiar) matur me koston e amortizuar. Detyrimi financiar eshte nje detyrim kontraktual per te dhene para ose nje aktiv tjetër financiar tek nje njesi ekonomike tjetër ose te shkembeje aktivin/detyrimin financiar ne kushtet te cilat jane potencialisht te pafavorshme per njesine ekonomike.

Detyrimi per te riinvestuar 13% te vleres totale te investimit eshte njohur si nje detyrim financiar meqenese daljet e burimeve qe perfaqesojne perfitime ekonomike, do te nevojiten per te mbyllur detyrimin ne 5 vitet e fundit te periudhes se marreveshjes. Ne vitit 2013, Shoqeria ka llogaritur vleren aktuale ne shumen LEK 62,319,620 te detyrimit per shumen e riinvestimit ne vleren ($13\% * 4,450,000,000 = 578,500,000$) duke perdorur nje norme borxhi te brendshme te shoqerise miratuar paraprakisht nga ortaket e shoqerise.

12. Kapitali Aksionar

Kapitali aksionar i shoqerise eshte 3,500,000 Leke:

	<u>31 dhjetor 2020</u>	<u>31 dhjetor 2019</u>
Numri i aksioneve	1,000	1,000
Vlera nominale (ne Leke)	3,500	3,500
Total	<u><u>3,500,000</u></u>	<u><u>3,500,000</u></u>

13. Shpenzimet e tatim fitimit

Perllogaritja e shpenzimit per tatimin mbi fitimin paraqitet me poshte per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2019:

	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020</u>	<u>Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019</u>
Fitimi (Humbja) para tatimit	(26,869,329)	(18,620,281)
Shpenzime te panjohura	531,061	299,424
Fitimi (Humbja) i tatueshem i vitit	(26,338,268)	(18,320,857)
Fitim/(Humbja) fiskale	(26,338,268)	(18,320,857)
Shpenzim tatim fitimi (15%)	-	-
Fitimi/(Humbja) Neto	<u><u>(26,869,329)</u></u>	<u><u>(18,620,281)</u></u>

FINSEC PORT SHA**Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020***(te gjitha shummat jane te shprehura ne lek)***14. Shpenzime shfrytezimi**

Shpenzime shfrytezimi me 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 perbehen nga sa me poshte:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019
Shpenzime ruajtje objekti	6,123,179	6,123,180
Sherbim konsulence menaxheriale-financiare	3,547,907	4,695,706
Konsulence ligjore	3,138,758	4,365,660
Shpenzime për pritje dhe përfaqësime	941,014	-
Blerje /shpenzime te tjera	738,014	272,809
Sherbime bankare	178,552	200,325
Taksa dhe tarifa vendore	107,401	128,100
Shpenzime permbarimore	-	26,000
Sherbim transporti	-	18,300
Qira	67,500	67,500
Total	14,842,325	15,897,580

15. Shpenzime te personelit

Shpenzime te personelit me 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 perbehen nga sa me poshte:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019
Shpenzime per paga	1,320,000	990,000
Shpenzime per sigurime shoqerore e shendetesore	220,440	165,330
Total	1,540,440	1,155,330

16. Shpenzime te tjera shfrytezimi

Shpenzime te tjera shfrytezimi me 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 perbehen nga sa me poshte:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2019
Gjoha dhe demshperblime	134,867	5,256
Total	134,867	5,256

FINSEC PORT SHA

Shenimet Shpjeguese te Pasqyrave Financiare per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020

(te gjitha shumet jane te shprehura ne lek)

17. Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme

Shpenzime e interesit me 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 perbehen nga sa me poshte:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	Per vitine mbyllur me 31 dhjetor 2019
Shpenzime per interesa (riinvestimi)	6,546,746	6,118,454
Te ardhura nga interesat	(44,250)	(873)
Total	6,502,496	6,117,581

18. Shpenzime të tjera financiare

Shpenzime financiare me 31 dhjetor 2020 dhe me 31 dhjetor 2019 perbehen nga sa me poshte:

	Per vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2020	Per vitine mbyllur me 31 dhjetor 2019
Humbje nga kembimet valutore	4,439,330	621,289
Fitim nga kembimet valutore	(590,119)	(5,176,755)
Total	3,849,201	(4,555,466)

19. Ngjarje pas bilancit

Drejtimi i Shoqerise nuk eshte ne dijeni te ndonje ngjarje pas dates se raportimit qe do te kerkonte rregullime ose paraqitje shtese ne pasqyrat financiare te veçanta, me perjashtim te dhenies se informacionit shpjegues si me poshte:

Ne dhjetor 2019, nje shperthim i nje lloji te ri te koronavirusit, COVID-19, u shfaq ne Wuhan, Kine, dhe brenda disa javesh numri i te infektuarve u rrit ndjeshem, dhe pertej kufijve te Kines, perfshire Shqiperine. Me 11 Mars 2020, Organizata Boterore e Shendetit njoftoi nje situatë pandemike per shkak te emergjences globale te shkaktuar nga shperthimi i COVID 19. Perhapja e koronavirusit ende po evoluon dhe efektet e saj mbeten te panjohura. Zhvillimi i shpejte i virusit Covid-19 dhe ndikimi i tij social dhe ekonomik ne Shqiperi dhe globalisht mund te rezultojne ne supozime dhe vleresime qe kerkojne rishikime te cilat mund te çojne ne rregullime materiale te vleres se mbetur te aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit te ardhshem financiar. Ne veçanti Drejtimi pret qe supozimet dhe vleresimet e perdorura ne percaktimin e rikuperueshmerise se aktiveve, lindja e detyrimeve te reja dhe perlllogaritjet kontabel te preken. Ne kete faze Drejtimi nuk eshte ne gjendje te vleresoje ne menyre te besueshme ndikimin pasi ngjarjet lidhur me Covid -19 po sjellin zhvillime te reja dita-dites. Ndikimi afatgjate mund te ndikojte gjithashtu ne vellimet e tregtimit, flukset e parave, dhe perfitueshmerine e Shoqerise. Sidoqofte, ne daten e ketyre pasqyrave financiare, Shoqeria vazhdon te permbushë detyrimet e saj sipas kushteve dhe per kete arsye vazhdon te zbatoje supozimin e vijimesise.




Nuk ka ngjarje te tjera te mepasshme pas dates se raportimit e cila kerkon rregullime apo shpjegime ne keto pasqyra financiare.

* * *

FINSEC PORT SH.A.

Faqja e nënshkrimit të anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës

Për Këshillin Mbikëqyrës të Finsec Port SHA, ky dokument u miratua dhe nënshkrua nga anëtarët si vijon:

ACCEPTED	THROUGH POA	Mukemiro, Fey
		
Roman Rolf Debrunner	Matthias Földeak	Denisa Vyshka
Kryetar	Zv/kryetar	Anëtar
Data e nënshkrimit	Data e nënshkrimit	Data e nënshkrimit

Shënime të anëtarëve: